VENDIM
Nr.257, datë 28.4.2005

PËR DHËNIE FONDI NDIHME PARTISË "LËVIZJA PËR TË DREJTAT DHE LIRITË E NJERIUT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 18 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 "Për partitë politike", të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Partisë "Lëvizja për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut" t'i jepet fondi prej 100 000 (njëqind mijë) lekësh, si ndihmë financiare.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
3. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano